



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.145 dt.29.09.1997

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.29.09.1997, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Ndërtim Strehimit “Mbi kriteret e përzgjedhjes së qytetarëve të pastrehë që kanë paraqitur dokumentacionin e duhur për tu trajtuar me kredi sipas V.K.M Nr.250, dt.16.04.1996 në zbatim të Ligjit Nr.8030, dt.15.11.1995, brenda kategorive që përmban ky Vendim”

VENDOSI

1. Miratimin e kriterëve të përzgjedhjes së qytetarëve të pastrehë që kanë paraqitur dokumentacionin e duhur për tu trajtuara me kredi sipas V.K.M. Nr.250, dt.16.04.1996 në zbatim të Ligjit Nr.8030, dt.15.11.1995, brenda kategorive që përmban ky Vendim si më poshtë :
 1. - Të trajtohen me përparësi të gjithë qytetarët që kanë dalë jashtë me Vendim Gjykatë.
 2. - Kur pronari ka statusin e ish – të përndjekurit politik.
 3. - Të kihet parasysh numri i pjestarëve të familjeve(sipas çertifikatës familjare me shënim gjendje 01.12.1992) për të njëjtën sipërfaqe banimi.
 4. - Për të njëjtin numër të familjarëve që banojnë në një sipërfaqe të njëjtë banimi do të kihet parasysh mosha e fëmijëve.
 5. - Gjendja shëndetësore e pjestarëve të familjes(nëse ndonjë prej tyre ka raport Mjeko – Ligjor).
 6. Kriteret e mësipërme brenda një nën ndarje të caktuar për kategorinë e parë do të vlejë edhe për kategorinë e dytë me përjashtim të pikës B.
 7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI

